

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS-kolegji i përbërë nga gjyqtarët: Emine Mustafa, kryetare, Avdi Dinaj dhe Nebojsa Boriçiq, anëtarë, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtores profesionale Minire Xhambazi, procesmbajtëse, në çështjen penale të të dënuarit I. L. nga Komuna e Prishtinës, për shkak të veprës penale lidhja e paautorizuar në shërbime nga neni 321 par. 1 të KPK, duke vendosur për kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë , të paraqitur nga i dënuari, të paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë, P.nr.42/2015 datë 9.6.2015, dhe aktgjykimit të Gjykatës së Apelit Prishtinë, PA 1.nr.1092/2015 datë 3.11.2015, në seancën e kolegjit të mbajtur më 30 mars 2016, mori këtë:

A K T G J Y K I M

Refuzohet si e pabazuar kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë e të dënuarit I. L., paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë, P.nr.42/2015 datë 9.6.2015, dhe aktgjykimit të Gjykatës së Apelit Prishtinë, PA 1.nr.1092/2015 datë 3.11.2015.

A r s y e t i m i

Me aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë, P.nr.42/2015 datë 9..2015 i dënuari I. L., është shpallur fajtor për veprën penale lidhja e paautorizuar në shërbime, nga neni 321 par. 1 të KPK dhe për këtë vepër penale është gjykuar me dënim burgu në kohëzgjatje prej 6(gjashtë) muaj dhe me dënim me gjobë në shumë prej 300 € njashtu që dënimet e shqiptuara nuk do të

ekzekutohen nëse i dënuari në afat prej një viti nuk kryen vepër të re penale. E dëmtuara për realizimin e kërkesës pasurore-juridike është udhëzuar në kontest civil.

Ky aktgjykim është vërtetuar me aktgjykimin e gjykatës së Apelit Prishtinë PA 1 nr.1092/2015 datë 3.11.2015.

Kundër këtyre aktgjykimeve në afatin ligjor kërkesë për mbrojtjen e ligjshmërisë ka paraqitur i dënuari I. L. përmes av. I. B., nga Prishtina, për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës penale dhe shkeljes së Ligjit penal me propozim që aktgjykimet e kundërshtuara të anulohen, çështja t'i kthehet gjykatës së shkallës së parë në rivendosje apo të ndryshohet, i dënuari të lirohet nga akuza.

Prokurori i Shtetit të Kosovës, me parashtrësën KMLP.II.nr.47/2016 datë 21.3.2016 ka propozuar që kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë të hedhet si e pasafatshme.

Gjykata Supreme e Kosovës, i shqyrtoi shkresat e çështjes konform dispozitave të nenit 4425 par. 1 dhe 426 par. 1 të KPPK-së, dhe pas vlerësimit të pretendimeve nga kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë, gjeti se:

Kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë nuk është e bazuar.

Në kërkesën e ushtruar nga i dënuari përmes mbrojtësit pretendohet se aktgjykimi i shkallës së parë është i përfshirë me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale nga neni 384 par. 1 pika 9 të KPPK-së, sepse dispozitivi i aktgjykimit të shkallës së parë është i pakuptueshëm, kundërthënës në brendinë e tij si dhe me arsyet e theksuara me aktgjykimet e kundërshtuara, për faktin se derisa në dispozitiv të aktgjykimit të shkallës së parë theksohet se i dënuari me datën 26.12.2013, në shtëpinë e tij ka këputur plumbën distributive në njehsorin elektrik, të cilin e kishin vendosur punëtorët e KED-sit, ka bërë rikyçjen e rrymës elektrike edhe pse ka qenë i çkyçur nga rrjeti elektrik për shkak të mospagesës së borxhit, kështu që në mënyrë të paautorizuar ka shfrytëzuar energjinë elektrike ku të dëmtuarës i ka shkaktuar dëm material, se me rastin e kontrollit më 26.7.2012, nga procesverbali i të dëmtuarit konstatohet gjendja e rregullt në njehsorin elektrik, se gjykatat i kanë bazuar aktgjykimet e kundërshtuara në provat e papranueshme dhe atë në procesverbalin e të dëmtuarës dhe të dy dëshmitarëve që janë punëtorë të KED-sit.

Përkritazi me shkeljen e Ligjit penal thekson se me provat e administruara nuk është vërtetuar se i dëmtuari ka kryer veprën penale për të cilën është shpallur fajtor.

Nga shkresat e çështjes rrjedh se i dënuari ka qenë shfrytëzuesi i energjisë elektrike të cilën nuk e ka paguar. Për shkak të mospagesës së borxhit në shumë prej 767,00 €, nga dëshmitarët I. M. dhe F. B., të cilët janë të autorizuar ta bëjnë licencimin e njehsorëve elektrik, shpërndarjen e faturave, kontrollin e njehsorëve dhe shkyçjen e konsumatorëve për shkak të borxhit të papaguar, vërtetohen rrethanat se për shkak të mospagesës së borxhit nga i dënuari me 23.12.2013, të dënuarin e kanë shkyçur nga rrjeti elektrik duke i vendosur pllombën distributive me nr. E....., ndërsa pas 3 ditësh, respektivisht më 26.12.2013, të njëjtit dëshmitarë kanë konstatuar se i dënuari sërish është kyçur në shfrytëzimin e rrjetit elektrik duke e hequr pllombën distributive. Nuk janë kontestuese rrethanat se dëshmitarët në këtë rast kanë përpiluar procesverbalin duke i konstatuar veprimet e ndërmarra nga dëshmitarët e po ashtu konstatojnë të gjeturat me rastin e daljes në vend, ku sërish të dënuarin e çkyçin nga rrjeti elektrik dhe me këtë rast bëjnë vendosjen e pllombës E..... në njehsor elektrik.

Pretendimet e të dënuarit në kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë se aktgjykimet e kundërshtuara mbështeten në prova të papranueshme nuk qëndrojnë për faktin se vetëm punëtorët e të dëmtuarës janë të autorizuar për leximin e njehsorëve elektrik, shpërndarjen e faturave si dhe shkyçjen e konsumatorëve nga rrjeti elektrik për shkak të mospagesës së borxhit, se me rastin e shkyçjes kanë përpiluar procesverbalin e datës 23.12.2013 të nënshkruar nga personat e autorizuar kurse më 26.12.2013 me daljen e sërishme në vendin e ngjarjes, të gjeturat në njehsor elektrik i konstatojnë në procesverbal , i cili është i nënshkruar nga dëshmitarët, duke i konstatuar edhe pllombat e vëna.

Nuk janë kontestues rrethanat se të dy dëshmitarët janë dëgjuar pranë gjykatës në shqyrtimin gjyqësor, të cilët i vërtetojnë rrethanat e konstatuara në procesverbal.

Po ashtu, pretendimet e të dënuarit se nga procesverbalet e prezantuara në kërkesë tregojnë gjendjen e rregullt në njehsorin elektrik të të dënuarit, këto rrethana nuk kontestohen as nga ana e gjykatave të shkallës së parë dhe asaj të shkallës së dytë për faktin se procesverbalet e prezantuara në kërkesë janë të datave 26.7.2012 dhe 14.12.2015, që vërtetojnë gjendjen faktike

në periudhat e ndryshme kohore, por jo edhe gjendjen e të gjeturave në periudhën kohore për të cilën i dënuari është shpallur fajtor.

Nga të theksuarat më lartë e konform dispozitës së nenit 437 të KPPK-së, është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS-PRISHTINË

Pml.nr.73/2016 datë 30 mars 2016

Procesmbajtëse,
Minire Xhambazi

Kryetare e kolegjit,
Emine Mustafa